

LIGJ
Nr.7500, datë 6.7.1991

PËR KRIJIMIN E KOMITETEVE EKZEKUTIVE TE PERKOHSHME PLURALISTE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjitnr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1

Të pezullohet veprimtaria e të gjitha këshillave popullorë të rretheve, rajoneve, qyteteve, lagjeve të qyteteve, fshatrave të bashkuara e të fshatrave deri në zgjedhjet e reja të organeve lokale të pushtetit.

Neni 2

Këshilli i Ministrave emëron dhe shkarkon komitetet ekzekutive të përkohshme pluraliste të rretheve e të rajoneve mbi bazën e propozimit të forcave politike në rreth, me konsensus.

Neni 3

Komitetet ekzekutive të përkohshme pluraliste të rretheve kanë të drejtë të shkarkojnë e të emërojnë përgjegjësit e seksioneve e të zyrave të tyre, si dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë më të ulëta.

Neni 4

Komitetet ekzekutive dhe këshillat popullorë atje ku nuk ka komitete ekzekutive, të vazhdojnë funksionimin e tyre deri në emërimin e organeve ekzekutive të përkohshme pluraliste.

Neni 5

Komitetet ekzekutive të përkohshme pluraliste ushtrojnë të gjitha kompetencat e njohura me ligj të organit që zëvendësojnë.

Neni 6

Gjyqtarët e gjykatave të rretheve e të zonave, kryetarët e zëvendëskryetarët e tyre, si dhe prokurorët e zëvendësprokurorët, emërohen dhe shkarkohen nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Ndihmësgjyqtarët e gjykatave të rretheve e të zonave, kur vendet e tyre mbeten bosh, caktohen nga komitetet ekzekutive të përkohshme pluraliste të rretheve.

Neni 7

Çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKES SE SHQIPERISE
RAMIZ ALIA